

Vendim nr. 299 datë 10.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 10.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 29 (SH) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SHPËTIM PROTODUARI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1239 (177), datë 09.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 25.02.2008 shtetasi Y.K. ka qenë duke punuar në objektin në pronësi të Shpëtim Protoduarit (*kërkuesi*) dhe është aksidentuar në punë, pasi ka rënë nga lartësia dhe ka pësuar dëmtime të rënda trupore që kanë çuar në humbjen e përhershme të aftësisë për punë. Në datën 25.03.2014 i dëmtuari Y.K. i është drejtuar me kallëzim Prokurorisë pranë Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Berat (*Prokuroria Berat*), pasi kallëzimi i bërë fillimisht në Policinë Gjyqësore, nga kjo e fundit, nuk ishte referuar në prokurori.

2. Prokuroria Berat, pasi ka regjistruar procedimin penal nr. 1027 të vitit 2014, në datën 29.12.2015 ka marrë, në cilësinë e të pandehurit, kërkuesin, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289, paragrafi 1, i Kodit Penal (*KP*) dhe me vendimin e datës 31.12.2015 prokurori i çështjes ka vendosur dërgimin e saj për gjykim. Ndërkohë drejtuesi i Prokurorisë Berat, me vendimin e datës 05.01.2016, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorit të çështjes për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr.1027 të vitit 2014 dhe pushimin e tij, me arsyetimin se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale, pasi nuk plotësohej një nga elementet e figurës së veprës penale, pikërisht qenia e kërkuesit subjekt i posaçëm i saj. Vendimi i drejtuesit të prokurorisë është ankimuar në gjykatë nga viktima e veprës penale, shtetasi Y.K.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur shfuqizimin e vendimit të drejtuesit të Prokurorisë Berat dhe urdhëruar vazhdimin e hetimeve, pasi ka vlerësuar se kërkuesi e plotëson kushtin për të qenë subjekt i posaçëm i veprës penale për të cilën është akuzuar në interpretim të legjislacionit në fushën e ndërtimit. Mbi ankimin e kërkuesit, si person i interesuar në proces dhe të Prokurorisë Berat, si dhe apelit kundërshtues të viktimës nga vepra penale, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 182, datë 20.12.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Edhe sipas gjykatës së apelit, kërkuesi përmbush kushtet për të qenë subjekt i posaçëm i asaj vepre penale, ndërsa ka qenë në cilësinë e investitorit në objektin në ndërtim ku ka ndodhur aksidenti në punë. Për rekursin e kërkuesit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-967, datë 26.07.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në të nuk paraqiteshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KP-së (*procesi i parë gjyqësor*).

4. Pas vendimit si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, Prokuroria Berat ka përfunduar hetimet paraprake dhe ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të kërkuesit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 532, datë 28.12.2017, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289, paragrafi 1, i KP-së, duke e dënua përfundimisht atë me 300.000 mijë lekë gjobë. Ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se në rastin konkret provohej ekzistenca e të gjitha elementeve të figurës së asaj vepre penale, përfshirë edhe qenia e kërkuesit subjekt i posaçëm i saj, për sa kohë, në interpretim edhe të legjislacionit në fushën e ndërtimit, provohej se ai ka qenë investitor në ndërtim dhe në këtë cilësi ka hyrë në marrëdhënie shërbimi, kundrejt pagesës, me viktimën nga vepra penale. Po kështu, edhe si punëdhënës, kërkuesi ka pasur detyrimin që të sigurojë mbrojtjen e punëmarrësve në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë

dhe shëndetin në punë, për sa kohë që aksidenti ka ndodhur gjatë kryerjes së një shërbimi që lidhet me ndërtimin në pronësi të tij, duke qenë ai edhe investitori i ndërtimit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, por edhe viktimja e veprës penale Y.K. në lidhje me dënimin e caktuar ndaj kërkuesit.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 51, datë 26.02.2020, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 532, datë 28.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe pushimin e çështjes, duke e vlerësuar atë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata e apelit ka konstatuar se viktimja nga vepra penale nuk gëzonte të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndaj çështja shqyrtohej prej saj vetëm me ankim të të pandehurit (kërkuesit). Për sa i përket themelit të çështjes, pasi ka evidentuar se procesi i parë gjyqësor dhe vendimi i marrë në përfundim të tij gjatë hetimit paraprak, nuk zëvendësonin gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykonin vendimin përfundimtar të saj, ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se kërkuesi, në cilësinë e investitorit, nuk është përgjegjës për garantimin dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik të tyre, ndërkohë që i dëmtuari nuk ka qenë i punësuar i tij, por sipërmarrës dhe zbatues i punimeve, ndaj, për pasojë, ka qenë ai përgjegjës për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në kryerjen e punës që kishte marrë përsipër, çka do të thotë se lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë me pasojën janë veprimet e vetë viktimës. Në mungesë të lidhjes shkakësore mes veprimeve e mosveprimeve të kërkuesit me pasojën e ardhur, sipas asaj gjykate, nuk vërtetohet ana objektive dhe subjektive në veprimet e kërkuesit, duke mos u plotësuar kështu elementet e figurës së asaj vepre penale, ndaj, për pasojë, çështja penale në ngarkim të kërkuesit duhet të pushohet. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë dhe viktimja e veprës penale, Y.K.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1239 (177), datë 09.07.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 51, datë 26.02.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 532, datë 28.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Ai kolegji fillimisht ka arsyetuar lidhur me moslegjitimitimin e viktimës nga vepra penale për të paraqitur rekurs dhe, në vijim, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e prokurorisë së apelit, i ka vlerësuar të drejta përfundimet e arritura nga gjykata e shkallës së parë dhe zbatimin e ligjit penal prej saj.

7. Në datën 10.10.2024, sipas shërbimit postar, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, duke kundërshtuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në procesin gjyqësor të themelit.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

- 8.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë, pasi ka tejkaluar kompetencat e saj, ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykata e apelit duke bërë një vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve, si dhe duke u dhënë atyre një cilësim të ndryshëm.
- 8.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi të njëjtët gjyqtarë të Gjykatës së Lartë që kanë shqyrtuar çështjen e themelit lidhur me fajësinë e kërkuesit, kanë gjykuar edhe rekursin lidhur me kundërshtimin e vendimit të datës 05.01.2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për pushimin e çështjes penale me nr. 1027 të vitit 2014 në ngarkim të tij për shkak të mungesës së fajësisë.
- 8.3. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi Gjykata e Lartë e ka shprehur më parë qëndrimin e saj lidhur me çështjen e kërkuesit, në shqyrtimin e rekursit lidhur me kundërshtimin e vendimit të datës 05.01.2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për pushimin e çështjes penale nr. 1027 të vitit 2014 në ngarkim të tij për shkak të mungesës së fajësisë. Në këtë mënyrë, ajo gjykatë e ka nisur gjykimin me dyshimin se ai është fajtor lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.
- 8.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimit të Gjykatës së Lartë i mungojnë argumentet se si ka arritur në përfundimin për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Ai është një vendim me arsytim të kufizuar, standard, që gjykata e ka pranuar në rastet e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit dhe jo kur Gjykata e Lartë prish vendimin e gjykatës së apelit, çka kërkon analizë të qartë dhe të plotë se përse është arritur në një vendim të tillë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që

cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual dhe ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës. Në rastin konkret, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuetit kanë lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 09.07.2024 të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 10.10.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Për sa i takon legjitimitin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të paanshmërisë në gjykim, parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues. Kolegji, bazuar në argumentet e paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të pretendimeve të tij, do të analizojë në vijim pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim të ndërlidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë, si dhe parimin e gjykatës së caktuar me ligj të ndërlidhur me standardin e arsytimit të vendimit.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë në gjykim të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë

14. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi të njëjtët gjyqtarë të Gjykatës së Lartë që kanë shqyrtuar çështjen e themelit lidhur me fajësinë e tij, kanë gjykuar edhe rekursin lidhur me kundërshtimin e vendimit të datës 05.01.2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për pushimin e çështjes penale nr. 1027 të vitit 2014 në ngarkim të tij për shkak të mungesës së fajësisë. Për këtë shkak, ajo gjykatë e ka nisur gjykimin me dyshimin se ai është fajtor lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet, duke cenuar në këtë mënyrë edhe parimin e prezumimit të pafajësisë.

15. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar, si dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e Gjykatës është pranuar se parimi i prezumimit të pafajësisë ka kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se

grykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga grykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në grykim (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Grykata, gjithashtu, ka vënë në dukje se Grykata e Lartë, sipas nenit 141 të Kushtetutës, ushtron rolin e saj si grykatë ligji për të gjithë territorin e vendit dhe për shkak të kësaj karakteristike kushtetuese, në parim, nuk përjashtohet mundësia që i njëjti gryqtar të japë disa vendime brenda të njëjtit proces gryqësor, nëse çështjet ligjore që shqyrtohen janë të ndryshme. Grykata, kur ka shqyrtuar pretendime për cenimin e parimit të paanësisë për shkak të pjesëmarrjes së të njëjtit gryqtar në dhënien e dy vendimeve në Gjykatën e Lartë, ka analizuar nëse vendimet e kundërshtuara janë marrë në përfundim të proceseve gryqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gryqtarëve. Sipas Gjykatës, pjesëmarrja e të njëjtëve gryqtarë në dy vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të grykimit nga një grykatë e paanshme (*shih vendimin nr. 22, datë 20.05.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe mbështetur në materialet e çështjes, Kolegji do të vlerësojë nëse përbërja e trupit grykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka cenuar ose jo parimin e paanshmërisë në grykim nga pikëpamja e testit objektiv, për rrjedhojë edhe parimin e prezumimit të pafajësisë.

20. Kolegji vëren se trupi grykues i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka dhënë vendimin nr. 00-2022-967, datë 26.07.2022 (*procesi i parë gryqësor*) dhe që ka vendosur mospranimin e rekursit lidhur me shfuqizimin e vendimit të drejtuesit të Prokurorisë Berat, rezulton të jetë e njëjtë me atë që ka dhënë vendimin nr. 00-2024-1239 (177), datë 09.07.2024 (*procesi i dytë gryqësor*) dhe që ka shqyrtuar themelin e çështjes së kërkuesit, duke vendosur prishjen e vendimit të grykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të grykatës së shkallës së parë, i cili kishte disponuar për shpalljen fajtor dhe dënimin e kërkuesit me gjobë.

21. Pavarësisht për sa më sipër, Kolegji konstaton se gjatë procesit të parë gryqësor Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka analizuar themelin e çështjes, por ka verifikuar plotësimin e kriterëve të pranueshmërisë së rekursit, duke vlerësuar se shkaqet e ngritura në të nuk janë sipas atyre për të cilat ligji procedural penal, neni 432 i KPP-së, lejon bërjen e rekursit. Kjo do të thotë se Grykata e Lartë në atë rast ka mbyllur shqyrtimin e çështjes në fazën seleksionuese të shqyrtimit të rekursit, ku vetëm ka analizuar faktin nëse çështja duhej të

shqyrtohej ose jo mbi bazën e rekursit të paraqitur, duke arritur në përfundimin se nuk duhej të shqyrtohej. Gjithashtu, ai proces dhe vendimet respektive të dhëna gjatë tij (sipas legjislacionit të kohës) lidhen me fazën e hetimeve paraprake dhe kanë pasur të bëjnë me verifikimin e kushteve të kërkuara nga ligji për dërgimin ose jo për gjykim të çështjes penale në ngarkim të kërkuarit. Ndërkohë që procesi gjyqësor i themelit dhe vendimet e dhëna gjatë tij kanë të bëjnë me të provuarin e veprës penale e të fajësisë së kërkuarit dhe në vijim me zbatimin e ligjit penal. Kolegji vëren se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në procesin e parë gjyqësor, për më tepër, nuk ka pasur asnjë ndikim në vijimin e procesit penal ndaj kërkuarit dhe në vendimmarrjen e gjykatave në procesin gjyqësor të themelit, pasi as prokuroria dhe as gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë referuar për ndonjë aspekt të procesit në atë vendim.

22. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se pjesëmarrja e të njëjtit trup gjykues në dhënien e dy vendimeve në Gjykatën e Lartë, *per se* nuk është element i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi vendimet e kundërshtuara janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata e vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve. Në këto kushte, vetëm fakti se trupi gjykues ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit në procesin e parë gjyqësor nuk përbën argument të mjaftueshëm për sa i përket qëndrimit të mbajtur në procesin gjyqësor të themelit, për rrjedhojë pjesëmarrja në trupin gjykues të të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna nuk krijon dyshim të justifikuar për paragjykimin e çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, për rrjedhojë, edhe ai i prezumimit të pafajësisë, janë haptazi të pabazuara.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit

23. Kërkuari ka pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë, pasi ka tejkalluar kompetencat e saj, ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykata e apelit, duke bërë një vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve, si dhe duke u dhënë atyre një cilësim të ndryshëm. Gjithashtu, është cenuar edhe standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimit të Gjykatës së Lartë i mungojnë argumentet se si ka arritur në përfundimin për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ai është një vendim me arsyetim të kufizuar, standard, që gjykata e ka pranuar në rastet e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit dhe jo kur Gjykata e

Lartë prish vendimin e gjykatës së apelit, çka kërkon analizë të qartë dhe të plotë se përse është arritur në një vendim të tillë.

24. Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Termi “gjykatë” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se në ushtrimin e funksionit si gjykatë e ligjit, ajo gjykatë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 44, datë 19.07.2016; nr. 36, datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjithashtu, sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe mbështetur në materialet e çështjes, Kolegji do të verifikojë nëse pretendimet e kërkuarit janë ose jo haptazi të pabazuara, se Gjykata e Lartë ka tejkaluar funksionin e saj si gjykatë ligji, pra se ajo ka rivlerësuar ndryshe nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm faktet dhe provat e administruara në gjykim, si dhe se vendimi i saj nuk përmbush standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

28. Kolegji vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuarit për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, duke e dënuar përfundimisht atë me 300.000 mijë lekë gjobë, ndërkohë që Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur prishjen e vendimit të asaj gjykate dhe pushimin e çështjes penale.

29. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nga ana e tij, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ndërsa ka vlerësuar se duke mbajtur në vëmendje elementet e veprës penale, të parashikuar nga neni 289, paragrafi 1, të KP-së, në raport me rrethanat e provuara gjatë gjykimit nga ana e gjykatave të faktit, gjykata e shkallës së parë ka dalë në një konkluzion të drejtë lidhur me fajësinë e kërkuarit. Ai kolegji e ka vlerësuar të drejtë zbatimin e ligjit penal nga gjykata e shkallës së parë referuar përfundimisht të saj se i pandehuri edhe si punëdhënës ka pasur detyrimin që të sigurojë mbrojtjen e punëmarrësve në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, për sa kohë që aksidenti ka ndodhur gjatë kryerjes së një shërbimi që lidhet me ndërtimin në pronësi të të pandehurit. Sipas asaj gjykate, Gjykata e Apelit Vlorë, në mënyrë të gabuar, ka konkluduar se kërkuari, duke mos pasur një kontratë pune me personat që punonin në objektin e tij, nuk ka pasur për detyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, se mungon lidhja shkakësore dhe se nuk vërtetohet ana objektive e subjektive e veprës penale. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt ligjin material dhe procedural penal në përputhje me standardin e të provuarit të fajësisë së kërkuarit “te çdo dyshimi të arsyeshëm”.

30. Duke marrë në analizë vendimin e Kolegjit Penal, Kolegji konstaton se ndryshe nga sa pretendon kërkuari, ai nuk ka bërë rivlerësim të fakteve e provave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, por, përkundrazi, ka zbatuar kompetencat e saj si gjykatë ligji, duke u bazuar në interpretimin e ligjit për të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara dhe të pranuar nga ato (*shih paragrafin 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sikurse rezulton nga vendimi, ajo gjykatë ka analizuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 289, paragrafi 1, i KP-së, në raport me faktet dhe rrethanat e provuara gjatë gjykimit nga gjykatat e faktit (*shih paragrafin 32 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Kontrolli i Gjykatës së Lartë në këtë rast është fokusuar vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimit të gjykatës së apelit dhe atij të gjykatës së shkallës së parë, pra mënyrës së zbatimit të ligjit. Për

ketë shkak, Kolegji çmon se nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë ripërcaktuar faktet apo të ketë vlerësuar provat ose të ketë nxjerrë konkluzion të ndryshëm për to në raport me atë të gjykatave të faktit.

31. Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është me arsyetim të kufizuar. Ajo ka marrë në shqyrtim çështjen në seancë, në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, duke arsyetuar lidhur me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, si dhe zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Vendimi përmban të dhënat e palëve në procesin gjyqësor penal, shkaqet e parashtruara në rekurs, vendimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku kanë mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Ndërkohë, nisur nga thelbi dhe përmbajtja e pretendimit të kërkuesit lidhur me arsyetimin e vendimit gjyqësor të kundërshtuar, rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë përmban një arsyetim të plotë për sa i përket zgjidhjes së çështjes së paraqitur përpara saj. Vendimi nuk duket që të përmbajë kontradikta, paqartësi ose pasaktësi të dukshme, duke respektuar kështu edhe elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Vetëm fakti se në përfundim procesi gjyqësor nuk ka shkuar në favor të kërkuesit, nuk është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim të drejtën e tij për proces të rregullt.

32. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.